



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 3668 / prot.

Pogradec, më 21.03 2026

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Znj. MANJOLA KAMOLLI
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëngjitur po Ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues : **“PËR MIRATIMIN
E PLANIT VENDOR TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TETOR
2026- TETOR 2031 PËR BASHKINË POGRADEC”**

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt!

KRYETAR
Ilir XHAKOLLI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KESHILLI**

Nr. ____ prot.

Pogradec, më ____, ____ 2026

**PROJEKT-VENDIM
Nr. ____, DATË ____/____/2026**

PËR

“MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TETOR 2026- TETOR 2031 PËR BASHKINË POGRADEÇ”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1 nënpika 1.1, nenit 23 pika 10, nenit 33, nenit 54 gërma k të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10 431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar, Ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, të ndryshuar me Ligjin nr.57 datë 16.10.2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, në VKM nr. 319, datë 31.5.2018 “Për Miratimin e masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, shkresën Nr.223 Prot datë 18.08.2026 të Agjensisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve SH.A si dhe, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve të Bashkisë Pogradec për periudhën tetor 2026- tetor 2031.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë .
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas përcaktimeve pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar!

KRYETAR

MANJOLA KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 3659/prot.

Pogradec, më 24.09.2026

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Znj. MANJOLA KAMOLLI
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëngjitur po Ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues : **"PËR MIRATIMIN
E PLANIT VENDOR TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TETOR
2026- TETOR 2031 PËR BASHKINË POGRADEC"**

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt!

KRYETAR
Ilir XHAKOLLI





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI**

Nr. ____ prot.

Pogradec, më ____, ____ 2026

PROJEKT-VENDIM
Nr. ____, DATË ____/____/2026

PËR

“MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TETOR 2026- TETOR 2031 PËR BASHKINË POGRADEC”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1 nënpika 1.1, nenit 23 pika 10, nenit 33, nenit 54 gërma k të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10 431, date 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar, Ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për Menaxhimin e IntegrUAR të Mbetjeve”, të ndryshuar me Ligjin nr.57 datë 16.10.2025 “Për menaxhimin e integrUAR të mbetjeve”, në VKM nr. 319, datë 31.5.2018 “Për Miratimin e masave për Kostot e Menaxhimit të IntegrUAR të Mbetjeve”, shkresën Nr.223 Prot datë 18.08.2026 të Agjensisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve SHA si dhe, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë planin vendor të menaxhimit të integrUAR të mbetjeve të Bashkisë Pogradec për periudhën tetor 2026- tetor 2031.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë .
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas përcaktimeve pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar!

KRYETAR

MANJOLA KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. 3624/Prot
7

Pogradec, më 21.03.2026

RELACION

MBI PROJEKT-VENDIMIN

PËR

"PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË
MBETJEVE TETOR 2026- TETOR 2031 PËR BASHKINË POGRADEC"

Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:

- 1) Akte administrative me karakter normativ
- 2) Akte administrative me karakter individual
- 3) Akte administrative me karakter kolektiv

Në Mbështetje të Nenit 13, pika 2 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar:
"Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj."

Po kështu, në Ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcaktohet: *"Akt me karakter normativ" janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që i drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore".*

Më tej, ky ligj në Nenin 8 shkronja "a" përcakton se : *"është përgjegjësi e Prefektit të Qarkut, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore."*

Nga sa më sipër, organet përgjegjëse pranë Bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të

miratohet në Këshillin Bashkiak do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë për përputhshmëri ligjore.

Akti nënligjor normativ është një nga mënyrat se si autoritetet e pushtetit shtetëror, të ndryshme nga Kuvendi, rregullojnë me norma me karakter të përgjithshëm çështje të cilat ligji ua ka njohur atyre ushtrimin e pushtetit.

Bazuar në ligjin 44/2015 "Kodi i Proçedurës Administrative", neni 3, pika 2 përcakton si vijon:

"Akt normativ nënligjor" është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij".

Neni 3 pika 1, shkronja "a" e Kodit të Proçedurës Administrative jep këtë perkufizim për "aktin administrativ":

a) "Akti administrativ individual" është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

b) "Akti administrativ kolektiv" është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Në rastin e këtij projekt-vendimi, gjykojmë se ai është një akt administrativ me karakter normativ, i cili plotëson elementet e përcaktuar në Nenin 3, pika 2 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Proçedurave Administrative", pasi është një akt i nxjerrë nga një organ publik në ushtrim të funksionit të tij, i cili sjell rregulla të përgjithshme dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij, si dhe me miratimin e tij do të ketë një ndikim të rëndësishëm për komunitetin dhe mjedisin. Ky projekt-vendim është veçanërisht i rëndësishëm për shkak të shtrirjes territoriale dhe karakteristikave urbane, rurale dhe turistike të territorit, duke mundësuar një qasje të integruar dhe të njëtrajtshme të shërbimit.

Përfundimisht konkludojmë se: Akti administrativ është i natyrës normative dhe si i tillë kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti i Qarkut Korçë, sipas legjislacionit në fuqi.

Konceptoi: N. NAUN



KRYETAR

Ilir XHAKOLLI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA POGRADEC

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. 368/Prot
17

Pogradec, më 20.07 2026

RELACION

MBI PROJEKT-VENDIMIN

PËR

"PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË
MBETJEVE TETOR 2026- TETOR 2031 PËR BASHKINË POGRADEC"

Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:

- 1) Akte administrative me karakter normativ
- 2) Akte administrative me karakter individual
- 3) Akte administrative me karakter kolektiv

Në Mbështetje të Nenit 13, pika 2 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar:
"Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj."

Po kështu, në Ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcaktohet: *"Akt me karakter normativ" janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që i drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njehershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore".*

Më tej, ky ligj në Nenin 8 shkronja "a" përcakton se : *"është përgjegjësi e Prefektit të Qarkut, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore."*

Nga sa më sipër, organet përgjegjëse pranë Bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të



miratohet në Këshillin Bashkiak do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë për përputhshmëri ligjore.

Akti nënligjor normativ është një nga mënyrat se si autoritetet e pushtetit shtetëror, të ndryshme nga Kuvendi, rregullojnë me norma me karakter të përgjithshëm çështje të cilat ligji ua ka njohur atyre ushtrimin e pushtetit.

Bazuar në ligjin 44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative", neni 3, pika 2 përcakton si vijon:

"Akt normativ nënligjor" është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij".

Neni 3 pika 1, shkronja "a" e Kodit të Procedurës Administrative jep këtë perkufizim për "aktin administrativ":

a) "Akti administrativ individual" është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

b) "Akti administrativ kolektiv" është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Në rastin e këtij projekt-vendimi, gjykojmë se ai është një akt administrativ me karakter normativ, i cili plotëson elementet e përcaktuar në Nenin 3, pika 2 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", pasi është një akt i nxjerrë nga një organ publik në ushtrim të funksionit të tij, i cili sjell rregulla të përgjithshme dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij, si dhe me miratimin e tij do të ketë një ndikim të rëndësishëm për komunitetin dhe mjedisin. Ky projekt-vendim është veçanërisht i rëndësishëm për shkak të shtrirjes territoriale dhe karakteristikave urbane, rurale dhe turistike të territorit, duke mundësuar një qasje të integruar dhe të njëtrajtshme të shërbimit.

Përfundimisht konkludojmë se: Akti administrativ është i natyrës normative dhe si i tillë kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti i Qarkut Korçë, sipas legjislacionit në fuqi.

Konceptoi: N. NAUN

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI



Bashkia Pogradec

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Tetor 2026 – Tetor 2031

PËRMBAJTJA

1	HYRJE	7
1.1	NEVOJA DHE QËLLIMI PËR FORTIMIN E PLANIT VENDOR TË MENAXHIMIT INTEGRUAR TË MISH-TËJEVE TË NJËRITA URBANE	7
2	KUADRI STRATEGJIK DHE LIGJOR	10
2.1	HIERARKIA E PLANIFIKIMIT	10
2.1.1	Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve	10
2.1.2	Plani Kombëtar Sektorial i Menaxhimit të Mbetjeve	10
2.1.3	Planet Zonale të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve	10
2.1.4	Planet Vendore të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve	11
2.1.5	Programi Kombëtar për Përndalimin e Krymës të Mbetjeve	11
2.2	POLITIKA KOMBËTARE NË FUQI	11
2.2.1	Politikat kombëtare dhe principat bazë të menaxhimit të mbetjeve	11
2.3	ASPEKTE TË INSTITUCIONALE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE	13
2.4	DETYRIMET LIGJORE	15
2.5	INSTRUMENTAT PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MISH-TËJEVE NË NIVEL VENDOR	19
2.5.1	Institucionet bashkiake të cilat hartojnë dhe zbatojnë instrumentat e menaxhimit	20
3	PËRSHKRIMI I SITUATËS SË PËRGJITHSHME	21
3.1	PROFILI BASHKISË	21
3.2	TË DHËNA DEMOGRAFIKE	23
3.3	TË DHËNA SOCIO-EKONOMIKE	24
3.4	KLIMA DHE RREZIQET NATYHORE	25
3.5	PERDORIMI I TOKES	25
3.6	RUGËT DHE INFRASTRUKTURA	26
3.7	ZONAT E MERCITURA	26
3.8	TURIZMI	26
4	SITUATA AKTUALE E MENAXHIMIT TË MBETJEVE NË BASHKI	28
4.1	ASPEKTE INSTITUCIONALE NË MENAXHIMIN E MBETJEVE NË BASHKINË POGRADEC	28
4.1.1	Organizimi i shërbimit	28
4.2	ASPEKTE TEKNIKE NË MENAXHIMIN E MBETJEVE NË BASHKINË POGRADEC	29
4.2.1	Të dhëna për sasinë e gjeneruar dhe përbërjen e mbetjeve	29
4.2.2	Skema e ofrimit të shërbimit në Bashkinë Pogradec	32
4.2.3	Shërbimi i pastimit të rrugëve, sheshëve, dhe rrymave ujore	35
5	ASPEKTET FINANCIARE NË MENAXHIMIN E MBETJEVE	36
5.1	KOSTO E PLOTË E SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE	36
5.2	SISTEMI I TARRIFAVE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE	36
6	ANALIZA E PERFORMANCËS SË SHËRBIMIT TË PASTRIMIT NË BASHKINË POGRADEC	38
6.1	VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM	38
6.2	PËRMBLECITJE SASIORE (VITET 2023–2024)	38
7	ANALIZA SWOT	41
8	PLANIFIKIMI STRATEGJIK	44
8.1	VIZIONI	44
8.2	OBJEKTIVAT	44

Lista e tabelave

Tabela 1: Fazat e procesit të hartimit të PVM-M në Bashkinë Pogradec	9
Tabela 2: Të dhënat për popullsinë në Bashkinë Pogradec	23
Tabela 3: Shpërndarja e institucioneve dhe bizneseve sipas NJA.....	24
Tabela 4: Tipologjitë hapësirë të shprehura në Së.....	25
Tabela 5: Statistikat e numrit të turistëve vendas dhe të huaj të akomoduar në hotele për vitet 2020-2024.....	27
Tabela 6: Lista e tshatrave që nuk i ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbetjeve	26
Tabela 7: Shkalla e mbulimit të shërbimit	29
Tabela 8: Sasia e mbetjeve të depozituara në Landfillin e Maliqit	30
Tabela 9: Rrymat e mbetjeve të grumbulluara sipas INSTAT.....	31
Tabela 10: Numri i kontenierëve të shpërndarë në Bashkinë e Pogradecit	33
Tabela 11: Të dhënat për buxhetin dhe shpenzimet për shërbimin e pastërtisë në Bashkinë Pogradec	36
Tabela 12: Niveli i tarifave të pastërtisë për kategoritë familjare.....	36
Tabela 13: Niveli i grumbullimit të tarifës sipas kategorive dhe realizimit të të ardhurave	37
Tabela 14: Niveli i mbulimit të koston.....	37
Tabela 15: Tabola krahasuese e treguesve të performancës për bashkinë Pogradec, vitet 2023-2024	39
Tabela 16: Koston për frymë dhe raportet e mbulimit	51
Tabela 17: Treguesit e produkt vitetit operacional	52
Tabela 18: Struktura tarifore dhe mbulimi i koston	53
Tabela 19: Aftësimet kryesore	54
Tabela 20: Kostonja totale që duhet mbuluar në vitet 2026-2031	66
Tabela 21: Të ardhurat potenciale dhe të ardhurat reale	66
Tabela 22: Hendeku financiar	67
Tabela 23: Lirëtimi i rritjes së ardhurave.....	67
Tabela 24: Përmbledhja e efekteve financiare.....	68
Tabela 25: Plan i Veprimtari për Bashkinë Pogradec për Menaxhimin e Mbetjeve (2026-2031)	73

Lista e figurave

Figura 1: Pozicioni gjeografik i bashkisë Pogradec.....	21
Figura 2: Harta administrative e bashkisë Pogradec	23
Figura 3: Harta e shprehjeve grafike të sasive të mbetjeve të depozituara në Landfillin e Maliqit	31
Figura 4: Shpërndarja e pikave të grumbullimit të mbetjeve në qytetin e Pogradecit.....	33
Figura 5: Shpërndarja e pikave të grumbullimit të mbetjeve në territorin e bashkisë Pogradec.....	34
Figura 6: Grafiku krahasues i treguesve të performancës për bashkinë Pogradec, vitet 2023-2024	40
Figura 7: Harta e Zonave të Administrimit të Mbetjeve.....	46

1 HYRJE

1.1 Nevoja dhe qëllimi për hartimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane

Planit Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (PVMIM) është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel lokal, si një dokument/ udhëzues i rëndësishëm për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Pogradec.

Ky plan mundëson orientimin strategjik për të ardhmen dhe njëkohësisht krijon një qendrim të përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për menaxhimin e mbetjeve në nivel lokal. Planit është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, riciklimit, trajtimit final dhe impianteve respektive të trajtimit të mbetjeve.

Qëllimi i planit konsiston në sfidën e re që ka bashkia për të ofruar shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e saj, duke harmonizuar interesat e të gjithë aktorëve për një menaxhim të qëndrueshëm, duke optimizuar koston e shërbimit kundrejt buxheteve të limituara që ka bashkia, ku do të krahasohen dhe vlerësohen të gjitha opsionet e mundshme si dhe në hartimin e nevojave për investime kapitale për sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Gjithashtu plani fokusohet edhe në përcaktimin e metodologjisë për zbatimin e sistemit të monitorimit, si dhe në ngritjen e kapaciteteve brenda bashkisë për zbatimin e planit.

Më konkretisht, ky plan ka si qëllim të mundësojë dhe sigurojë si më poshtë:

- Përputhshmëri me Ligjin 57/2026 dhe kuadrin ligjor plotësues, Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave kombëtare në fushën e mbetjeve
- Opsionet e menaxhimit të mbetjeve: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me objektivat kombëtare. Planit identifikon fushat dhe teknologjitë e duhura për minimizimin dhe depozitimin (asgjësimin) final të mbetjeve
- Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementeve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbetjet në të gjithë sistemin e menaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standardet e menaxhimit të mbetjeve
- Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve
- Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbetjet sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare.

Bashkia Pogradec tashmë përfshin një territor të zgjeruar me zona urbane, semi-urbane dhe rurale, ku prezantohen sisteme menaxhimi të ndryshme dhe mungesë e shërbimit në një pjesë të territorit. Sistemet kryesore për menaxhimin e mbetjeve kanë konsistuar vetëm në grumbullimin miks të mbetjeve të ngurta urbane dhe transportimin e tyre drejt vendeve të grumbullimit nën administrimin e vetë njësive vendore, por mungojnë nismat dhe politikat vendore, për të zvogëluar dhe diferencuar sasinë e mbetjeve në burim.

gjithë territorin e bashkisë por gjithashtu kanë qenë edhe vendimarrës në përcaktimin e opsioneve për menaxhimin e mbetjeve.

Procesi i hartimit të PVMIM në Bashkinë Pogradec kaloi në keto faza kryesore:



Tabela 1. Fazat e procesit të hartimit të PVMIM në Bashkinë Pogradec

2.1.4 Planet Vendore të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

Në nenin 65, përcaktohet se çdo bashki harton planin e vet të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin nën jurisdikcionin e saj. Ky plan duhet të jetë në përputhje me **Strategjinë Kombëtare dhe planin zonal**, dhe të përmbajë masa konkrete për menaxhimin e mbetjeve urbane, rymave specifike (si ambalazhet, plastika, qelqi, metal dhe mbetjet bio), si dhe parashikime për reduktimin dhe riciklimin.

Planet vendore miratohen nga **Këshilli Bashklak** pas miratimit teknik nga **AKEM-i** dhe duhet të përditësohen çdo pesë vjet.

Ky plan përbën dokumentin bazë të zbatimit në nivel lokal, duke përcaktuar shërbimet konkrete, infrastrukturën, koston dhe bashkëpunimin me operatorët dhe subjektet e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (EPR).

2.1.5 Programi Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve

Sipas nenit 66, përveç planeve kryesore, hartohet edhe një **Program Kombëtar për Parandalimin e Mbetjeve**, i cili synon uljen e sasisë së mbetjeve në bunm përmes masave ligjore, edukative dhe ekonomike. Ky program **përgatitet nga ministria përgjegjëse për mjedisin**, në koordinim me AKEM dhe bashkitë, dhe shërben si dokument mbështetës për planet strategjike të vendore.

2.2 Politika kombëtare në fuqi

2.2.1 Politikat kombëtare dhe principet bazë të menaxhimit të mbetjeve

Qeveria Shqiptare miratoi me VKM nr. 418, datë 27.05.2020 "Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035". Ky dokument strategjik do t'i mundësojë njësive të qeverisjes vendore një mjet mjaft frytdhënës për t'i udhëhequr ata në menyrë të duhur për hartimin e planeve të tyre lokale për menaxhimin e integruar të mbeturinave, duke u bazuar në 4 qëllime strategjike për periudhën 2020-2035:

Ky dokument politik, në vetvete, siguron udhëzime strategjike për menaxhimin e mbetjeve, duke udhëhequr vendimmarrjen lokale drejt marrjes dhe zbatimit të një sistemi të qëndrueshëm të administrimit të mbetjeve. Dokumenti i Politikave Strategjike udhëzon njësitë e qeverisjes vendore për përcaktimin e objektivave të tyre specifike vendore, të mësishëm, realiste, të arritshëm, bazuar në situatën e tyre ekzistuese dhe standardin minimal të miratuar për menaxhimin e mbetjeve.

Strategjia, përmes përcaktimit të rëndësisë së standardit minimal të menaxhimit të mbetjeve në nivelin lokal (*grumbullimi 100% i mbetjeve në zonat urbane, transporti i sigurt dhe depozitimi i mbetjeve vendodepozitimet e kontrolluara*), i ndjekur nga standardi ligjor (*mbledhja dhe trajtimi i diferencuar sipas rymave specifike të mbetjeve, përcaktuar në ligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve, ligji nr. 57/2026*), përcakton trajektoren që duhet të ndjekin njësitë vendore për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve. Nisur nga kjo, NJQV-të udhëzohen të përmbushin, së pari, standardin minimal për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve dhe më pas të planifikojnë hapat për të përmbushur standardin ligjor.



Qeveria Shqiptare është e angazhuar në procesin e anëtarësimit të plotë në BE dhe për këtë qëllim Ministria e Mjedisit është duke punuar drejt përafrimit dhe adoptimit të legjislacionit Shqiptar në përputhje me instrumentet legjislative të BE-së. Progresi më i madh në fushën e mbetjeve është bërë në fushën e legjislacionit. Gjatë periudhës 2011 - 2026, legjislacioni Shqiptar për Menaxhimin e mbetjeve është përmirësuar me ligje të reja, vendime dhe rregullore që reflektojnë direktivat e BE-së dhe detyrimet nga Konventa e Baselit.

2.3 Aspektete institucionale të menaxhimit të mbetjeve

Bazuar në Ligjin nr. 57, datë 16.10.2026 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", institucionet përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri janë të ndara në nivel qendror dhe vendor, secila me funksione të përcaktuara qartë. Më poshtë paraqitet një përshkrim i detajuar për secilën prej tyre:

➤ Ministria përgjegjëse për mjedisin (Ministria e Mjedisit)

(Neni 21)

Është institucioni kryesor në nivel qendror që drejton politikën shtetërore në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve. Ministria:

- Harton dhe zhvillon **politikën, legjislacionin dhe standardet kombëtare** për menaxhimin e mbetjeve.
- Përgatit dhe zbaton **Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe planin e veprimit** përkatës.
- Monitoron zbatimin e strategjisë dhe koordinon institucionet që kontribuojnë në arritjen e objektivave kombëtare.
- Zhvillon **fushata informuese dhe ndërgjegjësuese** mbi menaxhimin e mbetjeve, duke përdorur fonde publike ose burime të tjera ligjore

➤ Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve (AKEM)

(Neni 22)

▾ **Strukturat administrative të zonave të menaxhimit të mbetjeve (ZMM)**

(Neni 64)

Janë njësi të krijuara për të administruar bashkërisht menaxhimin e mbetjeve në një zonë të caktuar gjeografike, shpesh mbi bazë ndërbashkiake.

Funksionet e tyre janë:

- Hartimi dhe zbatimi i **Planeve Zonale të Menaxhimit të Mbetjeve**, në bashkëpunim me AKEM
- Raportimi vjetor për zbatimin e planit zonal dhe koordinimi me bashkitë për investime të përbashkëta.
- Sigurimi i funksionimit të **infrastrukturës ndërbashkiake** (p.sh. landfill-et, impiantet e trajtimit).

2.4 Detyrimet ligjore

Detyrimet e bashkive për menaxhimin e mbetjeve përcaktohen në ligjin organik, **Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"**, dhe në ligjin kuadër për menaxhimin e integruar të mbetjeve (Ligji 57/2026).

Sipas përcaktimeve të ligjit organik **139/2015** detyrimet e bashkive paraqiten si mëposhte.

- **Organizimi i shërbimeve publike të mbetjeve.** Sipas nenit 23 pika 10, bashkia është përgjegjëse për mbledhjen, transportin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake në territorin e saj. Ky shërbim është funksion ekskluziv i bashkisë dhe duhet të garantojë mbulimin e plotë të territorit.
- **Ofrimi i shërbimeve publike me standard.** Neni 32 përcakton që bashkia duhet të sigurojë që shërbimet publike – përfshirë menaxhimin e mbetjeve – të jenë cilësore, të aksesueshme dhe me kosto të përballueshme për të gjithë qytetarët. Kjo nënkupton clarifikim të standardeve dhe monitorim të performancës.
- **Zgjedhja e instrumenteve për administrimin e shërbimit.** Sipas nenit 33, bashkia mund të ofrojë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve përmes **ndërmarrjeve publike, partneriteteve publike-private apo kontraktimeve me operatorë privatë**. Në çdo rast, ajo mbetet përgjegjëse për **performancën, transparencën dhe monitorimin e traguesve të shërbimit**.
- **Bashkëpunimi ndër-bashkiak për shërbime të përbashkëta.** Neni 14 lejon dhe nxit bashkëpunimin midis dy ose më shumë bashkive për ushtrimin e funksioneve ose ofrimin e shërbimeve të përbashkëta, si p.sh. menaxhimi i mbetjeve. Bashkitë mund të ndajnë kostot, përgjegjësitë dhe përfitimet për investime ose infrastrukture të përbashkëta (p.sh. landfill-e ose impiante trajtimi).
- **Sigurimi i financimit dhe kapaciteteve për shërbimet publike.** Neni 22 pika 3 parashton që në rast se bashkia nuk ka burime të mjaftueshme për të përmbushur standardet e shërbimit qeverisja qendrore ofron **mbështetje financiare ose teknike**. Bashkia ka detyrimin të planifikojë burime njerëzore dhe financiare për funksionimin e përndrueshëm të shërbimit të mbetjeve.

- **Instrumentet ekonomike dhe kostot e shërbimit.** Bazuar në nenin 41, Këshilli i Ministrave miraton metodologjinë për llogaritjen e kostove operative për grumbullimin, pastrimin dhe transportin e mbetjeve. Bashkitë duhet ta zbatojnë këtë metodologji në përcaktimin e tarifave vendore dhe në kontraktimin e operatorëve të shërbimit, duke respektuar parimin "ndotësi paguan".
- **Monitorimi, kontrolli dhe ndalimi i hedhjeve të paligjshme.** Në zbatim të nenit 44, bashkitë janë të detyruara të monitorojnë territorin për të parandaluar hedhjet e paligjshme të mbetjeve dhe të marrin masa për pastrimin dhe rehabilitimin e zonave të ndotura. Ato duhet të bashkëpunojnë me institucionet e inspektimit dhe agjencitë mjedisore për të zbatuar sanksione ndaj shkelësve.

Tabela mëposhtë përmbledh detyrimet ligjore që burojnë për bashkitë nga Ligji nr. 57/2026 dhe shërben si bazë për kapitullin "Korniza Ligjore – Detyrimet e Bashkisë" në Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (PVMIM).

Tabela 1: Detyrimet ligjore që burojnë për bashkitë nga Ligji nr. 57/2026

NR.	DETYRIMI LIGJOR	REFERENCA (NENI)	MASA QË DUHET TË NDËRMARRË BASHKIA	AFATI I ZBATIMIT	NJËSIA PËRGJEGJËSE
1	Ngritja e sistemit bashkiak të menaxhimit të mbetjeve, përcaktimi i rregullave, pikave dhe orareve të grumbullimit	Neni 31 pika 1-3	Hartimi i rregullores bashkiake për grumbullimin e mbetjeve; përcaktimi i itinerareve, orareve dhe mbulimit të plotë të territorit	Afatgjatë – i përtëritshëm çdo 5 vjet	Drejtoria e Shërbimeve Publike / Ndërmarrja e Pastrimit
2	Garantimi i grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, me përparësi për mbetjet shtëpiake	Neni 31 pika 3-5	Organizimi i grumbullimit të diferencuar për rrymat kryesore (plastikë, letër, metal, qelq, bio)	Afatmesëm (1-3 vjet)	Drejtoria e Mjedisit / Operatorët e kontraktuar
3	Marrja e masave për ngritjen e sistemit të grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme dhe bio	Neni 31 pika 5	Zbatimi i ndarjes në burim për familjet dhe bizneset; vendosja e kontejnerëve me ngjyra	Afatshkurtër-mesëm	Drejtoria e Pastrimit / Drejtoria e Mjedisit
4	Bashkëpunimi me subjektet prodhuese në kuadër të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (EPR) dhe operatorët privatë	Neni 31 pika 6-8	Nënshkrimi i marrëveshjeve me PRO-të; koordinimi i raportimeve 6-mujore në AKEM	Vazhdueshëm	Drejtoria e Mjedisit / Sektori i Marrëdhënieve me Bizneset

	kostove operative dhe tarifave të shërbimit		parimit 'ndotësi paguan'		
13	Monitorimi i territorit dhe ndalimi i hedhjeve të paligjshme	Neni 44	Inspektime periodike, evidentimi i zonave problematike dhe marrja e masave ndëshkuese	Vazhdueshëm	Inspektorati i Mjedisit / Policia Bashkiake

2.5 Instrumentat për menaxhimin e integruar të mbetjeve në nivel vendor

Bazuar në ligjin kuadër për menaxhimin e integruar të mbetjeve, bashkitë duhet të hartojnë instrumentat vendorë për planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe kontrollin e shërbimit të mbetjeve, si:

- **Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane**, si instrumenti kryesorë i planifikimit për përcaktimin e vizionit dhe objektivat specifike, të mundshëm nga ana ekonomike dhe mjedisore, në lidhje me drejtimit që do të ndërmarrë bashkia në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Këto objektiva specifike duhet të reflektojnë orietimet e politikës kombëtare drejt menaxhimit të integruar të mbetjeve, të aktualizuara në gjendjen ekzistuese të bashkisë. Mbi bazën e objektivave specifike të dakordësuar në të gjitha nivelet vendimarrëse dhe me grupet e interesit, plani fillon dhe analizon skenarët e mundshëm të organizimit të shërbimit të shoqëruar me koston përkatëse dhe politikën fiskale që duhet të ndjekë bashkia në mbulimin e plotë të kostos. Ai përfundon me një plan veprimi konkret të ndarë në afate kohore, brenda një 5 vjeçari, sipas përgjegjësisë përkatëse të aktorëve të përfshirë në zbatimin e planit. Plani është një dokument planifikimi, i cili merr fuqi të plotë me miratimin nga Këshilli Bashkiak dhe Prefektura.
- **Rregulloret bashkiake për Menaxhimin e mbetjeve** për çdo rrymë specifike: është përgjegjësi e Bashkisë Pogradec të hartojë këto rregullore (duke zbatuar specifikat e ndarjes së re territoriale-administrative), e cila përcakton metodologjitë dhe rregullat për shërbimet e pastrimit të qytetit dhe Menaxhimit të mbetjeve për të gjitha rrymat specifike të mbetjeve, brenda territorit administrativ të bashkisë, duke hartuar procedura për ankesat e banorëve, gjithashtu edhe kapitulli për aplikimin e sanksioneve në rast të mos zbatimit të rregullores nga aktorë të ndryshëm. Rregullorja duhet të miratohet nga Këshilli Bashkiak për të marrë fuqi të plotë ligjore.
- **Rregulloret për llogaritjen e kostos dhe tarifave mbetjet**: Bashkia duhet të hartojë rregulloret përkatëse në lidhje me rregullat dhe procedurat për llogaritjen e kostos vjetore të shërbimit dhe nivelit të tarifave për konsumatorë të ndryshëm që janë pjesë e skemës, sipas modeleve të programuara.
- **Modeli i Sistemit të Monitorimit**: Monitorimi dhe vlerësimi i çdo aktiviteti është një element shumë i rëndësishëm në procesin e planifikimit të çdo operacioni në menaxhimin e mbetjeve. Një sistem i mirë monitorimi do të ndihmojë bashkinë në menaxhimin më të mirë të burimeve financiare, pasi nëpërmjet zbatimit të drejtë të tij do të përmirësohet procesi i planifikimit dhe në të njëjtën kohë përdorimi më i mirë i burimeve. Në këtë kuadër, Bashkia Pogradec duhet ta shtrirë modelin e monitorimit në të gjitha njësitë administrative, duke angazhuar edhe vetë administratorët e këtyre

3 PËRSHKRIMI I SITUATËS SË PËRGJITHSHME

3.1 Profili i Bashkisë

Bashkia e Pogradecit ndodhet në juglindje të Shqipërisë, në bregun jugperëndimor të Liqenit të Ohrit (695 metra mbi nivelin e detit). Kufizohet me Bashkinë e Prrenjasit në veri, Bashkinë e Pustecit në juglindje, Bashkinë e Maliqit në jug dhe Bashkinë e Gramshit në perëndim. Sipërfaqja e saj është 595 km² (sipërfaqe tokësore) dhe 108.9 km² (sipërfaqe ujore).

Pogradeci shquhet për pozicionin e tij gjeografik shumë të favorshëm, pasi shërben si urë kontakti që lidh shumë qytete, si dhe si pikë kalimi për në dhe nga Republika e Maqedonisë. Rruga kombëtare Tiranë - Korçë, pjesë e Korridorit VIII, kalon nëpër Bashkinë e Pogradecit, si dhe rruga e re lidhëse Qafë Thanë - Qafë Pllacë, dhe linja hekurudhore Pogradec - Elbasan. Në Bashkinë e Pogradecit, ka edhe dy pika doganore me Republikën e Maqedonisë, Tushemisht dhe Qafë Thanë. Territori i bashkisë përfshin elementë të rëndësishëm territorialë, si artificialë ashtu edhe natyrorë, siç janë Liqeni i Ohrit, Parku i Drilonit, Kalaja e Pogradecit, Lumi Shkumbin dhe Malet e Mokrës, ndër të tjera.




Figura 1: Pozicioni gjeografik i bashkisë Pogradec

Bazuar në reformën e re administrative dhe territoriale, të miratuar në Korrik 2015, Bashkia e madhe Pogradec përbëhet nga 8 Njësi Administrative (Pogradec, Udënisht, Bucimas, Cërravë, Dardhas, Proptisht, Trebinjë dhe Velcan), ku kryeqendra e bashkisë është qyteti i Pogradecit. Në të gjithë territorin administrative gjenden 72 fshatra. Në tabelën më poshtë



Figura 2: Harta administrative e bashkisë Pogradec

3.2 Të dhëna demografike

Sipas Regjistrimit të Popullsisë, CENSUS 2023, bashkia Pogradec ka një popullsi prej 46,070 banorësh. Ndërkohë, sipas Regjistrimit Civil 2024, kjo bashki ka 91,951 banorë.

Sipas CENS, dendësia e popullsisë është 77 banorë/km², ndërsa sipas regjistrimit civil, dendësia është 154 banorë/km². 43% e popullsisë klasifikohet si popullsi urbane dhe diferenca prej 57% është popullsi rurale. Në tabelën më poshtë jepen të dhënat për numrin e popullsisë:

Tabela 2. Të dhënat për popullsinë në Bashkinë Pogradec

NJËSITË ADMINISTRATIVE	POPULLSIA GJC 2024	% SIPAS TOTALIT	FAMILJE GJC 2024	POPULLSIA CENSUS 2023	POPULLSIA SIPAS MF
Pogradec	39,515	43%	14,167	19,798	25,713
Udenisht	7,756	8%	2,722	3,886	5,047
Buçimas	20,189	22%	6,554	10,115	13,137
Çerravë	9,478	10%	3,214	4,749	6,168
Dardhas	3,407	4%	1,198	1,707	2,217
Trebinjë	2,911	3%	1,007	1,458	1,894
Proptisht	5,804	6%	2,017	2,908	3,777

3.4 Klima dhe rreziqet natyrore

Pogradeci ka një klimë mesdhetare malore dhe pjesërisht kontinentale, me dimra të ftohtë dhe verë të nxehtë e të thatë. Temperatura mesatare vjetore është rreth 12.3 °C. Muaji më i ftohtë është janari dhe muaji më i nxehtë është gushti. Muaji më i lagësht është nëntori me një reshje mesatare prej 108 milimetrash, ndërsa reshjet mesatare vjetore janë 730 milimetra.

Pjesa shqiptare e zonës së Liqenit të Ohrit është e rrezikuar nga disa rreziqe natyrore si përmbytjet, rrëshqitjet e dheut, rënia e shkëmbinjve, erozioni dhe zjarret në pyje. Shumica e këtyre rreziqeve janë shkaktuar nga ndryshimet klimatike, rritja e presionit njerëzor mbi tokën dhe zhvillimi i paplanifikuar urban. Urbanizimi i shpejtë i viteve të fundit i ka detyruar njerëzit të ndërtojnë shtëpitë e tyre ose aktivitete të tjera në vende të pasigurta. Ndryshimi i klimës është një faktor tjetër që ka ndikuar në përmbytje dhe thatësira. Prania e relievit malor në pjesën perëndimore e kombinuar me dëmtimin e mbulesës bimore, luan një rol të rëndësishëm në gjenerimin e rrëshqitjeve të dheut dhe erozionit të tokës. Janë zhvilluar studime për të përcaktuar zonat e rrezikuara dhe masat për të minimizuar dëmet në humbjen e jetës, ekonominë dhe mjedisin.

3.5 Përdorimi i tokës

Pjesa më e madhe e territorit të Bashkisë së Pogradecit përbëhet nga kategoria e përdorimit natyror, bujqësor dhe rezidencial. Harta e përdorimit të tokës identifikon kategoritë e përdorimit si infrastruktura rrugore, uji, varrezat, arsimit, industria dhe ekonomia, institucionet, zonat shëndetësore dhe minerare, etj. Vihet re një përhapje më e madhe e kategorisë së arsimit dhe institucioneve në zonën urbane të Bashkisë së Pogradecit.

Tabela 4. Tipologjite hapsinore të shprehura në %

NR	EMËRIMI	%
1	Banesa te tipit njefamiljare, te grupuara dhe ne rjesht	11.39
2	Banesa te tipit njefamiljare te grupuara pjeserisht	33.69
3	Banesa shumefamiljare te tipit kulle	3.32
4	Banesa shumefamiljare (2&3 kateshe te shperndara)	2.37
5	Administrata mikes	1.67
6	Biznese	27.25
7	Varreze	0.67
8	Gjelberim + Pemetore	11.33
9	Toke buqesore	4.16
10	Siperfaqe urbane te braktisura	1.62
11	Kazerma ushtarake dhe bashkeshoqeruese	0.28
12	Te tjera Shkolla, kisha, xhami etj.	1.89

Një analizë e thelluar e përdorimit të tokës është hartuar në "Strategjinë e Zhvillimit të Territorit" dhe Planin e Përgjithshëm Rregullues Vendor të Bashkisë së Pogradecit në zbatim

Si rrjedhojë, bazuar në të dhënat e marra nga Drejtoria për Zhvillimin e Turizmit dhe Promocionin të grumbulluara në hotelet e territorit të bashkisë, bashkinë Pogradec e kanë vizituar rreth 135,904 turistë për vitin 2024, nga këta 24,736 turistë të huaj dhe 111,168 turistë vendas.

Tabela 5. Statistikat e numrit të turistëve vendas dhe të huaj të akomoduar në hotele për vitet 2020-2024

VITI	TURISTË TË HUAJ	TURISTË VENDAS	GJITHSEJ
2020	5,055	55,879	50,824
2021	4,447	55,391	59,838
2022	11,871	67,970	79,841
2023	21,489	100,221	121,710
2024	24,736	111,168	135,904

Çërravë	Çërravë, Blacë, Bletas, Alarup, Pretushë, Grabovicë, Nizhavec, Kodras, Leshnicë, Lumas, Qershizë	11	
Dardhas	Dardhas, Stropckë, Grunjas, Prenisht, Dardushë, Osnat, Lekas, Nicë, Stërkanj	9	Grunjas, Prenisht, Dardushë, Osnat, Lekas, Nicë, Stërkanj
Trebinjë	Trebinjë, Çezmë e Madhe, Çezmë e Vogël, Hondisht, Selcë e Sipërme, Llëngë, Plenisht, Hoshtecë, Zemcë, Podgozhan, Malinë, Kalivaç, Prevelan, Dunicë, Guri i Bardhë	15	Çezmë e Madhe, Çezmë e Vogël Llëngë, Plenisht, Hoshtecë, Zemcë, Guri i Bardhë
Proptisht	Proptisht, Rodokal Sipër, Rodokal Poshtë, Homezh, Slabinjë, Somotinë, Kriçkovë, Selcë e Sipërme, Selcë e Poshtme, Homçan, Vërrë, Golik, Slatinë, Baribardhë, Selishtë, Zalltore	15	Slatinë, Baribardhë, Selishtë
Velçan	Velçan, Buzahishtë, Shpellë, Bishnicë, Jollë, Losnik, Laktesh, Senishtë	8	Shpellë, Bishnicë, Jollë, Senishtë

Kompania kryen shërbimin e menaxhimit të mbetjeve (grumbullim dhe transport) gjatë 7 ditëve të javës, për qytetin dhe NJA Udënisht, Bucimas, Çërravë, dhe Dardhas si dhe 2 ditë në javë për NJA Proptisht, Trebinjë dhe Velçan. Sasia mesatare e mbetjeve që grumbullohet është rreth 35 ton/ditë¹ të cilat më pas transportohen dhe trajtohen në Landfillin sanitar të Maliqit, në një distancë prej 30 km nga qendra e qytetit.

4.2 Aspekte teknike në menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Pogradec

4.2.1 Të dhëna për sasinë e gjeneruar dhe përbërjen e mbetjeve

Në Bashkinë Pogradec numri i popullsisë që marin shërbimin është 76,345 nga 91,951 persona të regjistruar në regjistrin e gjendjes civile. Pra, shkalla e mbulimit të shërbimit të ofruar për person është rreth 83%. Nëse krahasojmë sasinë e gjeneruar me sasinë e mbetjeve të dërguara në landfill për vitin 2024, mund të vlerësojmë shkallën e mbulimit të shërbimit.

Gjenerimi i mbetjeve është përlogaritur sipas zonave të shërbimit, për zonën urbane 0.9 kg/person/ditë, për zonën gjysëm-urbane 0.5-0.6 kg/person/ditë dhe për zonën rurale 0.3 kg/person në ditë.

Tabela 7. Shkalla e mbulimit të shërbimit

BASHKIA POGRADE	NR.	BASHKIA POGRADE	TON/VIT
Nr. i popullsisë – Gjendja civile	91,951	Sasia e mbetjeve të dërguara dhe peshuara në Landfillin e Maliqit 2024	13,019.3
Nr. i popullsisë që mbulohen me shërbim	76,345	Parashikimi i gjenerimit të mbetjeve 2024	15,643
Shkalla e mbulimit	83%	Shkalla e mbulimit	83%

¹ Kjo vlerë i referohet mbetjeve të peshuara nga Landfilli i Maliqit për vitin 2024




Figura 3: Paraqitje grafike e sasisë së mbetjeve të depozituara në Landfillin e Maliqit

Nga të dhënat e siguruara nga INSTAT vërehet se mbetjet organike përfaqësojnë përbërësin kryesor të mbetjeve të ngurta bashkiake. Në periudhën kohore të paraqitur, kjo pjesë e mbetjeve ka një tendencë rritje nga 41% në 2013 në 58.1% në 2022.

Tabela e mëposhtme ofron një përmbljedhje të përbërjes merceologjike të mbetjeve të gjeneruara në bashkinë Pogradec, duke u mbështetur nga të dhënat e INSTAT mbi raportin e mbetjeve të ngurta urbane për vitin 2022.

Tabela 9. Rrymat e mbetjeve të grumbulluara sipas INSTAT

RRYMAT E MBETJEVE	%	SASIA E MBETJEVE QË SHKOJNË NË LANDFILL 2024 (TON/VIT)
Plastikë	9.2%	1197.8
Letër + Karton	8.9%	1158.7
Metal	2.2%	286.4
Organike	58.1%	7564.2
Qelq	4.9%	637.9
Dru	3.6%	468.7
Tekstil	4.5%	585.9
Inerte	5.9%	768.1

Tabela 10. Numri i kontenierëve të shpërndarë në Bashkinë e Pogradecit

ZONA	NJËSIA ADMINISTRATIVE	KONTENIERË (1.1 M3)
Urbane	Pogradec	135
Gjysëm-Urbane	Udenisht	50
	Buçimas	80
	Çërravë	25
	Dardhas	25
Rurale	Trebinjë	25
	Proptisht	45
	Velçan	25
TOTAL		410




Figura 4: Shpërndarja e pikave të grumbullimit të mbetjeve në qytetin e Pogradecit

Për ofrimin e shërbimit në të gjithë territorin, kompania e kontraktuar përdor dy mjete teknologjike me kapacitet 10 ton dhe pesë mjete teknologjike me kapacitet 5-7 ton, me një brigadë prej rreth 50 punonjës nga të cilët rreth 20 janë të dedikuar për menaxhimin e mbetjeve dhe pjesa tjetër janë të dedikuar në fshirje dhe larje të rrugëve.

Në fshatrat ku nuk ofrohet shërbimi komuniteti zbaton sistemin e vet-groposjes në zonat e paracaktuara nga vetë banorët, të cilat mund të jenë perrenj, grapa të krijuara nga vetë banorët, rrëpira etj.

4.2.3 Shërbimi i pastrimit të rrugëve, shesheve, dhe rrymave ujore

Shërbimi i fshirjes së rrugëve, shesheve dhe trotuareve kryhet manualisht me fshesë çdo ditë të muajit në qytetin e Pogradecit me një sipërfaqe prej 261.758 m², në NJA Bucimas me një sipërfaqe prej 77.410 m² dhe në NJA Udenisht me një sipërfaqe prej 66.000 m², pra në total 405.168 m²/ditë. Pas aktivitetit të fshirjes, hedhurat grumbullohen dhe transportohen me karrocë dore deri në pikën e grumbullimit më të afërt. Shërbimi kryhet gjatë turnit të natës ndërmjet orarit 21:00-04:00, dhe gjatë turnit të ditës ndërmjet orarit 10:00-19:00.

Operatori i shërbimit kryen fshirje me fshesë teknologjike për të gjitha rrugët dhe sheshet e përcaktuara në kontratë me një sipërfaqe prej 30.000 m², dhe ky shërbim kryhet 1 herë në javë gjatë orarit 21.00-04:00.

Operatori i shërbimit kryen larjen e rrugëve me presion me makinë teknologjike 2 herë në ditë vetëm gjatë sezonit veror (183 ditë në vit) të një sipërfaqe prej 18,600 m². Gjithashtu operatori kryen larjen e qendrës si dhe disa shesheve të përcaktuara në kontratë 1 herë në javë vetëm për 3 muajt e verës (12 ditë në vit) të një sipërfaqe prej 20,000 m². Të dyja këto shërbime kryen pas orarit të fshirjes së rrugëve 24.00-07:00 dhe 12.00-18.00.

Në kontratë është përcaktuar që kompania e pastrimit do të mirëmbajë-pastrojë edhe disa lumenj/perrenj. Kjo sipas kontratës bëhet nga punëtorët e pastrimit 2 herë në javë dhe pastrimi i thellë kryhet me eskavator 1 herë në vit për lumin e qytetit, lumin e Cërnavës, lumin e Vërdovës, Guri i Kuq, Memëlisht, Rrëmënj, Gurras.

Gjithashtu, operatori i shërbimit kryen edhe mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve nga dëbora në sezonin e dimrit.

Per cdo shtepi banimi me oborr, i cili eshte me shume se 100m2	Lekë/vit	4,800	4,800	4,800	3,300	1,200
--	----------	-------	-------	-------	-------	-------

Ndërkohë tarifat për kategorinë e **biznesit të vogël** variojnë sipas kategorive të ndryshme si edhe njësive administrative, **nga 360 – 240,000 lek/vit** për biznes.

Për kategorinë e **biznesit të madh** tarifat variojnë sipas kategorive të ndryshme si edhe njësive administrative, **nga 8,400 – 350,000 lek/vit** për biznes.

Në lidhje me grumbullimin e tarifës, Bashkia e Pogradecit mbledh tarifat e pastrimit nëpërmjet faturës së ujit dhe kanalizimeve për familjet dhe bizneset që kanë kontratë me ndërmarrjen publike të furnizimit me ujë dhe kanalizime. Familjet dhe bizneset që nuk kanë kontratë duhet të paguajnë tarifën e pastrimit në zyrat e njësive administrative. Departamenti përgjegjës në bashki për nivelin e mbledhjes së tarifave është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave.

Nga të dhënat e deklaruar nga bashkia, niveli i grumbullimit të tarifës gjatë katër viteve të fundit vlerësohet të jetë rreth 70-80%, ndërsa kosto e mbulimit të shërbimit për këtë nivel tarife të grumbulluar është jo më shumë se 73%, siç tregohet në tabelat më poshtë.

Tabela 13. Niveli i grumbullimit të tarifës sipas kategorive dhe realizimit të të ardhurave

KATEGORIT Ë		2021	% REALIZIM I	2022	%	2023	%	2024	%
Familje	Plan	80,000,000	59.6%	79,320,000	71.1%	78,320,000	65.2%	78,500,000	77.0%
	Fakt	47,662,402		56,393,147		51,065,756		60,430,747	
Bisnese	Plan	43,000,000	86.4%	47,558,000	79.3%	47,058,000	97.1%	64,000,000	78.9%
	Fakt	37,143,400		37,732,692		45,697,367		50,480,000	
Institucione	Plan	-		600,000	100.0 %	600,000	100.0 %	720,000	100.0 %
	Fakt	3,000,000		600,000		600,000		720,000	
Total	Plan	123,000,000	71.4%	127,478,000	74.3%	125,978,000	77.3%	143,220,000	77.9%
	Fakt	87,805,802		94,725,839		97,363,123		111,630,747	

Tabela 14. Niveli i mbulimit të koston

VITI	REALIZIMI I GRUMBULLIMIT TË TARIFËS (LEKË/VIT)	BUXHETI I SHËRBMIT (LEKË/VIT)	% E MBULIMIT TË KOSTOS
2021	87,805,802	140,000,000	62.7%
2022	94,725,839	156,000,000	60.7%
2023	97,363,123	152,849,920	63.7%
2024	111,630,747	152,994,800	73.0%

të veçanta për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme dhe çdo iniciativë e këtij lloji, çka tregon se fusha e riciklimit është në fazë fillestare.

- **D2 – Shkalla e trajtimit të mbetjeve sipas normave (100%).** Ky tregues përmirësim të dukshëm që prej 5 vitesh, pasi gati 95% e mbetjeve dërgohet në landfillin rajonal të Maliqit. Megjithatë, mbeten pika ilegale të hedhjes së mbetjeve, veçanërisht në zonat e thella rurale pa shërbim të rregullt.
- **E1 – Mbulimi i kostos së shërbimit (63.7% → 72.9%).** Ky tregues mat aftësinë e bashkisë për të mbuluar koston e shërbimit me të ardhurat nga tarifa e pastrimit. Për Pogradecin, kjo përqindje tregon një përmirësim të ndjeshëm dhe ofron vetëqëndrueshmërie ekonomike mbi mesataren.
- **E2 – Shkalla e mbledhjes së tarifës (77.2% → 77.9%).** Edhe pse niveli i mbledhjes është i lartë, ai nuk pasqyron domosdoshmërisht efikasitet real, pasi tarifa faturohet për kategori që jo gjithmonë marrin shërbimin. Kjo krijon diferenca midis arketimeve të planifikuara dhe shërbimit realisht të ofruar.
- **Kosto për ton (10,687.8 → 11,106.1 lekë/ton).** Kosto për ton tregon rritje të vogël të menaxhimit operativ, por niveli mbetet i lartë për një bashki me volum mesatar mbetjesh, duke sugjeruar futjen në ekonominë e shkallës.
- **Kosto për banor (1,876.1 → 2,417.2 lekë/banor/vit).** Ky tregues reflekton një rritje të koston mesatare për banor, por kjo mund të lidhet më shumë me rritjen e numrit të turistëve si edhe me rritjen e efijencës së shërbimit.
- **G – Cilësia e përgjithshme e shërbimit (17% → 17%).** Ky është treguesi sintetik që përfshin të gjithë treguesit e mësipërm. Përqindja e ulët e këtij treguesi tregon se përmirësimet teknike nuk kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e perceptuar të shërbimit dhe cilësinë e jetës së qytetarëve, gjithashtu edhe mungesa e një plani menaxhimi, zbatueshmëria e tij si edhe fushatat e ndërgjegjësimit qytetar, kanë qënë inegzistente.

Në përmbledhje, Bashkia Pogradec përballët me **sfida të konsiderueshme** në aspektin e organizimit, dhe përfshirjes së komunitetit. Pavarësisht progresit të treguar në trajtimin teknik të mbetjeve, mungesa e ndarjes në burim, riciklimit dhe kontrollit të pikave ilegale mbetet problem kyç. Shërbimi ka nevojë për **investime të reja në pajisje, ngritje kapacitetesh dhe rritje të ndërgjegjësimit qytetar**, në mënyrë që të sigurohet një sistem i qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe i vetëfinancues.

Tabela 15: Tabela krahasuese e treguesve të performancës për bashkinë Pogradec, vitet 2023-2024

	Viti	2023	2024
C	Indikatori C1, Mbulimi i zonës me shërbim (në %)	77%	83%
	Indikatori 1. Zona Urbane - Mbulimi i zonës me shërbim	100%	100%
	Indikatori 1. Zona Rurale - Mbulimi i zonës me shërbim	57%	64%
	Indikatori C2, Cilësia e pastrimit	65%	65%
	Indikatori C3, Kënaqësia e publikut	0%	0%
D	Indikatori D1, Shkalla e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve	0%	0%

7 ANALIZA SWOT

Analiza SWOT paraqet një vlerësim të përgjithshëm të gjendjes aktuale të sistemit të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Pogradec, duke evidentuar pikat e forta dhe dobësitë e brendshme të organizimit, si dhe mundësitë dhe kërcënimet që vijnë nga mjedisi i jashtëm institucional, ekonomik dhe mjedisor. Qëllimi i kësaj analize është të ndihmojë në përcaktimin e prioritetëve strategjike dhe në identifikimin e masave që mund të përmirësojnë performancën dhe qëndrueshmërinë e shërbimit të pastrimit. Duke u bazuar në këtë vlerësim, Bashkia Pogradec mund të ndërtojë politika më efikase për menaxhimin e integruar të mbetjeve, duke maksimizuar avantazhet ekzistuese dhe duke minimizuar sfidat që ndikojnë në ofrimin e një shërbimi të qëndrueshëm dhe cilësor për komunitetin.

S Pikat e Forta (Përparësitë)	➤ Territoret e bashkisë së Pogradecit janë prioritet ndërkombëtar dhe kombëtar për shkak të statusit të tyre mbrojtës, sidomos zona breg liqenore, çka e orienton zhvillimin drejt politikave të qëndrueshme mjedisore. ➤ Bashki e mesme si nga ana e popullsisë, ashtu edhe e territorit, çka krijon lehtësi në organizimin dhe menaxhimin e shërbimit të pastrimit. ➤ Territor turistik, me sasi relativisht të konsiderueshme të mbetjeve të riciklueshme dhe potencial për ndarjen në burim të tyre dhe qasjen drejt ekonomive qarkulluese. ➤ Territori rural, me sasi të ulët mbetjesh të paketimeve dhe potencial për kompostim në shtëpi apo reduktim të mbetjeve organike. ➤ Interes i lartë për ruajtjen e pastërtisë për shkak të rëndësisë turistike të qytetit dhe Liqenit të Ohrit. ➤ Mbledhje e rregullt e mbetjeve në zonën urbane dhe mbulim relativisht i mirë me shërbim pastrimi. ➤ Performacë sipër mesatares kombëtare në lidhje me grumbullimin e tarifës së shërbimit.
W Dobësitë	➤ Strukturë e pa konsoliduar e menaxhimit të mbetjeve në bashki si dhe mangësi në monitorimin e shërbimit dhe të dhënave të sakta. ➤ Burime financiare të kufizuara, që ndikojnë në aftësinë për të investuar në infrastrukturë moderne dhe teknologji të avancuar të menaxhimit të mbetjeve. ➤ Infrastrukturë kontenerësh e pamjaftueshme dhe e amortizuar për grumbullimin, transportin dhe trajtimin e mbetjeve. ➤ Rrjet rrugor rural i dobët, që pengon ofrimin e shërbimit të rregullt dhe të pandërprerë në të gjithë territorin.

	u Pamundësia për të realizuar të ardhurat nga tarifat për shkak të nivelit të ulët të të ardhurave të popullsisë dhe rezistencës ndaj pagesës. v Pamundësia për ofrimin e shërbimit në të gjithë territorin për shkak të konfiguracionit malor dhe kushteve të vështira gjeografike, që rrisin koston dhe rrezikun e ndotjes mjedisore.
--	---

individuale apo të bashkuara dhe materialet e konsumit, që janë pjesë përbërëse e ketyre pajisjeve, mbetjet e baterive, mbetjet e vëlrimshme, duka përfshirë mobilien, çyshkët dhe të ngjashme,

b) mbetje të perziera dhe mbetje të grumbulluara në mënyrë të diferencuar nga burime të tjera, kur këto mbetje kanë natyrë dhe përbërje të ngjashme me mbetjet shtëpiake

Mbetjet bashkiake nuk përfshijnë mbetjet nga prodhimi, çuqësia, syjet, peshkimi, gropat septike, rrjetin e kanalizimeve dhe trajtimin të ujrave të ndotura, sistemin e kullimit, si dhe llumrat e ujërave të ndotura, automjetet në lund të jetës, mbetjet nga ndërtimi dhe shembja. Ky parafundim nuk cenon ndarjen e përgjegjësisve për menaxhimin e mbetjeve midis aktorëve publikë dhe privatë.

Cjithashtu, ligji përcakton si (pika 22) "Mbetje bre" mbetjet e biodegradueshme nga kopshtet e shtëpive dhe parqet, mbetjet ushqimore e të gatimit nga shtëpitë, zyrat, restorantet, kateringut, kartinat dhe ambientet e shijës me pakicë e shumicë, si dhe mbetjet e ngjashme nga impiantet e përpunimit të ushqimeve

Sipas burimit të gjenerimit mbetjet urbane (bashkiake) klasifikohen në dy ryma:

- Mbetjet e gjeneruara nga fam ljet (MF)
- Mbetjet e gjeneruara nga bizneset dhe ndusintë (MB), ku përbërja e mbetjeve nuk ndryshon nga karakteristikat e mbetjeve urbane

Ndërkohë, ryma të tjera të mbetjeve klasifikohen si mbetje voluminoze, mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (inerte), mbetje nga kopshtet që prishohen në famije dhe që quhen mbetje nga aktivitetet bujqesore në ferme, për të cilat duhet të ofrohet një alternative e përshtatshme, si kompostimi individual për familet fermere të zones rurale

8.4 Zonat e Administrimit të Mbetjeve (ZAM) dhe përfituesit e shërbimit të pastrimit

Për një organizim më të mire të shërbimeve dhe eticencës së sistemit që do të propozohet, zonat e mbetjeve ose zona brenda kufijve administrative të bashkisë do ndahet në nën-zona mbetjesh që kanë diferencë në lidhje me tipologjinë urbane, infrastrukturën rrugore apo llojin e konsumatorëve. Kjo do të shërbejë për të planifikuar infrastrukturën e nevojshme për skemat e mbledhjes dhe transportit, si dhe shërbime të tjera të ngjashme. Për këtë qëllim, zona e mbetjeve ndahet në këto 3 nënzona:

8.5 Shërbimet e menaxhimit të mbetjeve

Në këtë plan 5 vjeçar, Bashkia Pogradec parashikon këto shërbime kryesore të menaxhimit të mbetjeve, të cilat konsistojnë në:

- Shërbimi i pastrimit, grumbullimi (sipas rastit të veçantë), transportit të mbetjeve;
- Depozitimi i mbetjeve në landfill-in e Malqit;
- Zbatimi i masave për parandalimin, minimizimin dhe futjen e sistemeve të menaxhimit integruar të mbetjeve.

Këto shërbime pasi do të shpjegohen shkurtimisht më poshtë, do të përfshihen në skenarët e propozuar nga bashkia për organizimin e shërbimit në territorin e saj gjatë viteve 2028-2031.

8.5.1 Shërbimet e pastrimit të rrugëve

Organizimi i shërbimeve të pastrimit duhet të marrë në konsideratë nevojat për pastrimin e rrugëve dhe shkallën e ndotjes ditore nga mbetjet, apo brenda një periudhe të caktuar ditësh. Për këtë qëllim propozim i frekuencave për secilën kategori rrugësh duhet të jetë objekt i një vlerësimi apo testi dori në përcaktimin përfundimtar të specifikimeve teknike të mundshme në rast se ky shërbim do të kontraktohet në të ardhmen.

Një element shumë i rëndësishëm në organizimin e shërbimeve të pastrimit të rrugëve është edhe kategorizimi i rrugëve në funksion të rëndësisë si më poshtë:

Kategoria e Parë: (përfshin rrugët kryesore dhe rrugët tregtare) nevojitet shërbimi ditor i fshirjes, është më i paraceloyer pastrimi me makinë teknologjike i akseve kryesore (kur është e mundur dhe ka efektivitet), por dhe mirembajtja e tyre gjatë ditës, vendosja dhe pastrimi ditor i koshave rrugore, si dhe shërbimi i larges gjatë verës;

Kategoria e Dytë: (rrugët kryesore me aktivitet të ulët komercial dhe me densitet të ulët kalimtarësh) fshirja manuale e rrugëve është e nevojshme të kryhet çdo ditë të javës

Kategoria e Tretë: (sistem rrugor periferik në zona me dendësi të ulët urbane, apo në zona me infrastrukturë jo të rregullt dhe rrugë të paasfaltuara) është i nevojshëm një shërbim mujor pastrimi (fshirje ose thjosht mbledhje mbetjesi dhe hedhurinash).

8.5.2 Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve

Në parashikimin e shërbimeve të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, bashkia do të marrë në konsideratë parimin për parandalimin e ndotjes, Cilësia dhe kostat e shërbimit të mbledhjes dhe largimit të mbetjeve urbane lidhen drejtpërdrejtë me mënyrën se si konsumatorët hedhin mbetjet, përdorin PGM, respektojnë oraret e përcaktuara dhe zbatojnë rregullat lokale për menaxhimin e mbetjeve. Në këtë aspekt, bashkia duhet të plotësojë kuadrin e saj rregullator në shtet të:

- Hartimit të një rregulloreje vendore për menaxhimin e mbetjeve, ku do të përcaktohen procedurat, protokollet e punës, parashikimet se çfarë do të ndodh në rast avarishi apo aksidentesh në punë, të drejtat dhe detyrimet e të gjitha grupeve të interesit të përfshira në menaxhimin e mbetjeve si dhe gjatë përkatese në rasti të shkeljeve të evidentuara.

9 PLANIFIKIMI OPERACIONAL

9.1 Analiza e fazave të zhvillimit për zbatimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve

Fazat për organizimin e shërbimit në Bashkinë Pogradec, bazohen në planifikimin strategjik të paraqitur më lart. Bazur në këtë planifikim janë hartuar analizat teknike dhe financiare dhe përcaktuar dy faza planifikimi drejt arritjes së objektivave të planit të cilat do të synojnë, në nivele të caktuara, ofrimin e një shërbimi me standarde sa më të larta, me kosto optimale dhe të përballueshme nga taksa paguesit. Këto faza përcaktohen më poshtë bashkë me afatet përkatëse.

Plani operacional do të jetë subjekt përditësimi në pëputhje me zhvillimet në Zonën e Mbetjeve Korçë. Për këtë arsye në këtë plan 5 vjeçar janë përcaktuar plane masash të arritshme në përputhje me infrastrukturën aktuale që kanë Zona e mbetjeve. Me rëndësi për zhvillim në këtë zonë mbetjesh janë pikat e transferimit, impiantet e ndarjes së mbetjeve dhe ndarjes së mbetjeve në burim. Kjo infrastrukturë mungon dhe nuk pritet të jetë instaluar së paku në fazën afatshkurtër (2026-2027).

Bazuar në sa mësipër është hartuar një analizë e plotë teknike dhe financiare e cila merr në shqyrtim performancën aktuale të bashkisë (përballueshmërinë financiare dhe teknike) dhe duke u bazuar në objektivat e vendosur në plan ndërton hapat konkrete operationale për kapërcimin e vështirësive dhe arritjen e këtyre objektivave në kuadrin 5 vjeçar të këtij plani. Kjo analizë jepet si mëposhtë.

9.1.1 Përshkrim i zonave dhe kostove të përgjithshme

Zona Urbane

Zona urbane, që përfshin qytetin e Pogradecit dhe Tushemishtin, ka dendësinë më të lartë të popullsisë dhe gjenerimin më të madh të mbetjeve (**0.89 kg/banor/ditë**). Sipas modelit, projektohen **8,395 ton/vit** që kërkojnë **225 kontejnerë** (me vëllim 1.1 m³ secili) dhe **një kamion kompaktor 21 m³** që operon në **dy turne në ditë**.

- **Efiçenca:** Frekuenca e lartë (7 ditë në javë) dhe puna me dy turne sigurojnë mbulim të plotë dhe ruajtje të standardeve të pastërtisë urbane.
- **Logjistika:** Nevojitet **një kamion kompaktor 21 m³** i cili do të punojë me dy turne, si edhe **225 kontejner** (me vëllim 1.1 m³ secili).
- **Kosto:** OPEX prej **2400 ALL/ton** dhe **895 ALL/banor/vit** tregon përdorim të optimizuar të stafit dhe pajisjeve.
- **Shfrytëzimi i burimeve:** Çdo kamion punon afër kapacitetit maksimal operacional me **85% shfrytëzim të mjetit**.
- **Nevoja për investime:** Kryesisht për zëvendësimin e kontejnerëve (**8,988,000 ALL**) dhe blerjen e një kamioni kompaktor 21 m³ (**14,000,000 ALL**).

Përgjigja ndaj objektivave të KPI:

- **Kosto:** OPEX është më i larti, 4550 ALL/ton për shkak të nënshfrytëzimit të kapaciteteve të mjeteve dhe stafit, si dhe distancave të gjata të transportit (mbi 50 km për udhëtim).
- **Nevoja për investime:** Kryesisht për zëvendësimin e kontejnerëve (6,240,000 ALL) dhe blerjen e një kamioni kompaktor 14 m3 (10,000,000 ALL).
- **Amortizimi për ton (2290 ALL/ton)** tregon mungesë ekonomie shkalle dhe joefikasitet të përdorimit të kamionëve standardë në zona me volum të ulët mbetjesh.

Përgjigja ndaj objektivave të KPI:

Ky skenar përmbush **Objektivin** – “mbulimi minimal i zonave rurale”, por bie ndesh me parimin e optimizimit të koston. Rekomandohet kalimi drejt modeleve alternative të shërbimit, si pika satelitore/tw ndwrmjetme grumbullimi, mjete të përbashkëta ndërfshtarash, ose stacione transferimi me kontejnerë të mëdhenj, për të reduktuar ngarkesën operative dhe koston për ton.

9.1.2 Interpretim sasior: treguesit e eficiencës dhe raportet e mbulimit të kostove

Për të vlerësuar se si organizimi operacional (sistemi i grumbullimit, transferimit dhe depozitimit) i shërbimit të grumbullimit përmbush objektivat strategjike të këtij plani, janë analizuar treguesit për njësi për banor dhe për njësi për ton, raportet e mbulimit financiar dhe efikasiteti operacional për secilën zonë të menaxhimit të mbetjeve. Shifrat e paraqitura në tabelat në vazhdim bazohen në një model të avancuar përlogaritje të shërbimit të përdorur në këtë rast.

Tabela 16: Kostot për frymë dhe raportet e mbulimit

ZONA	MBETJE E GJENERUAR (T/VIT)	POPULLLSIA	OPEX (ALL/T)	OPEX TOTAL (000 ALL/VIT)	ÇMIMI PËR NGRITJE TË 1 KONTEJNERI (ALL/VIT)	TARIFA PËR FRYMË (ALL/VIT)
Urbane (Pogradec + Tushemisht)	8,395	25,713	2,400	201,691	7,856	895
Gjysmë-urbane (Hudënisht-Buçimas-Çerravë-Dardhas)	5,575	26,569	2,900	163,000	6,136	730
Rurale (Proptisht-Trebinjë-Velçan)	827	7,552	4,552	38,000	5,032	749

Interpretim:

- Zona **urbane** ka efikasitetin më të lartë ekonomik, falë densitetit dhe përdorimit të plotë të kapaciteteve.

Në kuadër të objektivitetit të politikave për mbulimin e kostove, rekomandohet:

1. **Diferencim tarifor zonal** (koeficient për densitetin e banimit).
2. **Mekanizëm të ndërsbvencionimit** – të ardhurat e zonës urbane mbulojnë pjesërisht shërbimin rural.
3. **Përfshirje graduale të amortizimit në bazën e tarifës**, për të siguruar vetëfinancim të flotës së mjeteve dhe kontejnerëve pas 7–10 vitesh.

9.1.4 Përmirësimet strategjike të propozuara

a. Riorganizimi i itinerareve dhe integrimi logjistik

- Bashkimi i itinerareve **gjysmë-urbane me rurale** në korridore të përbashkëta (p.sh., Dardhas–Proptisht–Velçan), me shërbim qarkullues çdo 3–4 ditë.
- Krijimi i **pikave të përkohshme të transferimit** (kontejnerë 5–7 m³) për të shmangur transportet e gjata drejt landfillit të Maliqit, duke ulur konsumin e karburantit me 25–30%.
- Përdorimi i **sistemeve GPS dhe peshoreve digjitale** për monitorimin e performancës në kohë reale.

b. Diversifikimi i flotës

- Zëvendësimi i kamionëve kompaktorë standardë në zonat rurale me **mjete të lehta 5–7 m³ ose kamion me rimorkio**, për fleksibilitet dhe kosto më të ulët mirëmbajtjeje (deri në 40%).
- Në zonat urbane, pilotimi i **mjeteve elektrike ose hibride** përgjatë aksit Pogradec–Tushemisht, për të ulur ndotjen dhe për të harmonizuar shërbimin me politikat e BE për tranzicion të gjelbër.

c. Ndarja dhe trajtimi i mbetjeve organike

- Duke qenë se rreth **58% e mbetjeve janë organike**, rekomandohet ngritja e **dy njësive kompostimi** (një pranë Pogradecit dhe një në Çerravë) me kapacitet trajtimi prej 2,000 t/vit, duke devijuar të paktën 25% të mbetjeve nga landfilli.
- Në zonat rurale, nxitja e **kompostimit në familje** me pajisje të thjeshta, duke ulur nevojën për transport me 35–40%.

Tabela 18: Struktura tarifore dhe mbulimi i kostove

ZONA	TARIFA E PROPOZUAR (ALL/FRYMË/VIT)	MEKANIZMI FINANCIAR	OBJEKTIVI I MBULIMIT 2031
Urbane	950–1000	Teprica mbulon zonën rurale	110% (vetëfinancim)
Gjysmë-urbane	800–850	Balancuar	100%

Këto masa do të garantojnë përputhje me **standardet e BE-së**, qëndrueshmëri ekonomike, dhe një shërbim të drejtë e të qëndrueshëm për të gjithë banorët e territorit të Bashkisë Pogradec.

10.2 FAZA I – AFAT SHKURTËR (2026–2027)

Synim: Optimizimi i shërbimit ekzistues, ngritja e bazës për ndarjen në burim dhe rritjen e transparencës financiare

NR.	OBJEKTIVI / KPI I LIDHUR	AKTIVITETI / MASA	PËRSHKRIMI TEKNIK	INVESTIMI (ALL)	REZULTATI / TARGETI 2026-2027	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARTNERË / BURIM FINANCIIMI
1	C1, C2	Riorganizimi i itinerareve të mbledhjes në zonat gjysmë-urbane dhe rurale	Kryerja e një analize GIS për rrjetin e itinerareve, matja e distancave, kombinimi i fshatrave me flukse të ulëta, dhe planifikimi i orareve më efikase për reduktimin e kilometrave bosh. Zbatimi do të bëhet me asistencë teknike, duke instaluar GPS në automjete.	2,000,000	Reduktim 20% i konsumit karburanti	Drejt. Shërbimeve	AKEM, EU4CELC
2	C2, G	Rehabilitimi i 50 pikave ekzistuese të grumbullimit	Përmirësimi i bazamentit të betonit, vendosja e mbulesave metalike për mbrojtje nga reshjet, ndriçim solar dhe tabela orientuese për ndarjen e mbetjeve. Punimet do të kryhen me kontraktim publik dhe mbikëqyrje nga Bashkia.	4,000,000	90% pika me standard urban	Bashkia	Buxhet vendor
3	C2, G	Blerja e 2 automjeteve pastrimi mekanik dhe 1 larje rrugësh <u>Shënim:</u> Ky investim parashikohet vetëm në rast të	Harimi i specifikimeve teknike, prokurimi, dhe trajnimi i operatorëve për përdorim efikas. Do të përdoren	8,000,000	Rritje e pastrimit ≥75%	Bashkia	Institucione Financiare Ndërkombëtare (IFN) / AKEM

NR.	OBJEKTIVI / KPI I LIDHUR	AKTIVITETI / MASA	PËRSHKRIMI TEKNIK	INVESTIMI (ALL)	REZULTATI / TARGETI 2031	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARTNERË / BURIM FINANCIIMI
5	C3	Platformë digjitale GIS për raportime qytetare dhe menaxhim shërbimesh	Zhvillimi i një platforme online ku qytetarët raportojnë raste ndotjeje dhe bashkia menaxhon statuset në kohë reale përmes GIS.	3,000,000	Kënaqësi ≥70%	Bashkia / IT	AKEM / OJF
6	C1, D2	Program kompostimi familjar për 500 familje	Shpërndarja e kompostuesve plastikë, trajnime në komunitet për procesin, krijimi i një rrjeti familjar "ambasadorësh të kompostimit".	2,500,000	500 ton bio trajtuar në burim	Bashkia / OJF	AKEM / IFN
7	E1, E2	Integrimi i pagesës së tarifës në sistemin fiskal online	Zhvillim i portalit të pagesave për familjet dhe bizneset me kod unik dhe histori arkëtimi. Lidhje me Drejtorinë e Financave për ndjekje të detyrimeve.	2,500,000	95% arkëtim real	Bashkia / Financa	AKEM
8	C1	Ndërtimi i 3 stacioneve të reja të grumbullimit për zonat e thella rurale	Instalimi i stacioneve me kontejnerë 7 m³ dhe mbulesa; mbledhje javore me kamion të përbashkët ndërmjet fshatrave.	5,000,000	Mbulim rural ≥90%	Bashkia / NMT	AKEM
9	G	Trajnime vjetore për stafin dhe operatorët e pastrimit	ASPA do të zhvillojë trajnime për standarde të shërbimit, komunikim me publikun, menaxhim O&M dhe siguri pune.	1,000,000	Cilësi ≥70%	ASPA / Bashkia	ASPA / AKEM

10.4 MASA MBËSHTETESE DHE MONITORIMI

MASA	QËLLIMI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	TREGUES / FREKUENCA
Sistemi vjetor i raportimit KPI	Përditësim i 8 indikatorëve sipas VKM 538/2021	Bashkia / AKEM	Raport çdo vit
Komiteti Bashkiak për Menaxhimin e Mbetjeve	Mbikëqyrje dhe vlerësim i zbatimit të planit	Bashkia / Prefekti	Mbledhje çdo 6 muaj
Inspektime mjedisore të përbashkëta (Bashkia + RAPA)	Kontroll i pikave ilegale dhe ndotjes	Bashkia / RAPA	0 pika ilegale
Përfshirja e sektorit privat	Kontraktim me operatorë riciklimi / MRF Maliq	Bashkia / Privat	≥3 kontrata aktive
Trajnime ASPA për stafin e pastrimit	Rritje e profesionalizmit dhe zbatimit të standardeve	ASPA / Bashkia	2 trajnime/vit
Përfshirja e komunitetit	Forume lokale për mbetje, anketime, edukim publik	Bashkia / OJF	2 evente/vit

10.5 TREGUESIT E PERFORMANCËS (KPI) DERI NË 2031

KPI	VLERA 2024	OBJEKTIVI 2031	BURIMI I TË DHËNAVE
C1 – Mbulimi me shërbim	83%	100%	Raport Bashki-AKEM
C2 – Pastërtia e territorit	65%	85%	Inspektime bashkiake
C3 – Kënaqësia e publikut	0%	70%	Anketa vjetore
D1 – Ndarja në burim	0%	40%	Raport EU4CELC
D2 – Trajtimi i mbetjeve bio	0 t/vit	2,000 t/vit	Raport kompostimi
E1 – Vetëfinancimi i sistemit	73%	100%	Financa bashkiake
E2 – Mbledhja e tarifës	77.9%	95%	Regjistër fiskal

11 STRATEGJIA E RIKUPERIMIT TË KOSTOS

11.1 Hyrje

Ky kapitull ofron një analizë të thelluar të gjendjes financiare të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Pogradec.

Qëllimi është të shpjegohet me thjeshtësi:

- sa kushton sot sistemi,
- sa të ardhura siguron tarifa,
- çfarë hendeku financiar krijohet nga kostot e reja,
- dhe si mund të mbyllet ky hendek me masa të drejta, të përballueshme dhe të balancuara për qytetarët dhe bizneset.

Për të lehtësuar kuptueshmërinë, çdo tabelë shoqërohet me shpjegim tekstual dhe çdo hap i strategjisë paraqitet qartë si më poshtë vijon.

11.2 Situata aktuale financiare e shërbimit të mbetjeve

Bashkia Pogradec aktualisht operon me një buxhet të konsoliduar, i cili përfshin:

- kostot e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve,
- pastrimin e hapësirave publike,
- mirëmbajtjen e mjeteve dhe kontejnerëve,
- shpenzime operative dhe administrative.

Tabela e mëposhtme paraqet **situatën reale të vitit të fundit**, duke treguar se cili është raporti mes buxhetit të planifikuar, shpenzimeve faktike dhe të ardhurave nga tarifa.

Table 3: Gjendja financiare aktuale

TREGUESI	VLERA (ALL/VIT)
Buxheti total i planifikuar (2024)	152,994,800
Shpenzimet aktuale të realizuara	144,594,000
Të ardhurat reale nga tarifa (78% arkëtim)	143,220,000

Shpjegim:

- Shërbimi real kushton **144.6 milion ALL/vit**,
- Tarifa mbledh **143.2 milion ALL**,
- Diferenca është minimale (rreth -1.37 milion ALL), pra sistemi sot është thuajse i balancuar.

TOTAL	184,400,000	143,832,000
--------------	--------------------	--------------------

Shpjegim:

- Nëse tarifa do të mbledhej 100%, bashkia do të arkëtonte **184.4 milion ALL**, shumë më tepër se sa kostoja.
- Por me **78% arkëtim**, të ardhurat janë vetëm **143.8 milion ALL**, pra **20% më pak** se potenciali.

11.5 Hendeku financiar 2026–2031

Duke krahasuar të ardhurat reale me kostot e reja:

Tabela 22: Hendeku financiar

PËRSHKRIMI	ALL/VIT
Kosto totale	167,514,000
Të ardhura reale nga tarifa	143,220,000
Hendeku financiar	-24,294,000

Bashkia duhet të sigurojë **24.3 milion ALL në vit** për të mbuluar shërbimin pas investimeve të reja.

Ky hendek nuk mund të mbyllet pa masa shtesë financiare.

11.6 Strategjia për rikuperimin e kostove 2026–2031

Strategjia është ndërtuar mbi tre shtylla, jo me rritje horizontale të tarifave, por me ndërhyrje të balancuara dhe të drejta.

11.6.1 Shtylla 1 – Rritja e arkëtimit nga 78% → 90%

Rritja e arkëtimit është mënyra më e drejtë dhe më efektive për të rritur të ardhurat, pasi: nuk rëndon familjet, nuk rrit tarifën pa nevojë, rrit disiplinën financiare, ul informalitetin.

Tabela 23: Efekti i rritjes së arkëtimit

NIVEL ARKËTIMI	TË ARDHURA (ALL/VIT)
78% (aktual)	143,220,000
90%	165,960,000
Rritja	+22,740,000

- rritjen e frekuencës,
- ndarjen në burim,
- kompostim,
- pastrim të thelluar të zonave turistike.

11.8 Strategjia 5-vjeçare me hapa të qartë

Për të siguruar që transformimi të jetë i butë, i drejtë dhe i zbatueshëm, rekomandohet që masat të ndahen sipas viteve.

2026 – Stabilizimi

- Arkëtimi target 85%
- Rritje për bizneset gjeneruese +10%
- Rritje rurale +10%
- Nis zbatimin e investimeve

2026 – Harmonizimi

- Arkëtimi 88%
- Rritje biznesesh +10%
- Vendosija e tarifës së sezonalititetit
- Pilotimi i ndarjes në burim

2027 – Optimizimi

- Arkëtimi 90%
- Tarifa rurale arrin 1800 ALL
- Fillon kompostimi dhe ulja e tonazhit në landfill

2028 – Konsolidimi

- Arkëtimi 92%
- Reduktim i kostove operative përmes optimizimit të flotës

2029–2031 – Vetë-mbulimi i plotë dhe rezervë investimesh

- Arkëtimi 94–95%
- Tarifa rurale finalizohet 1800–2000 ALL
- Bizneset gjeneruese rriten në mënyrë graduale
- Sigurohet vetë-mbulim + fond investimesh

12 PLANIFIKIMI I FUSHATAVE TË NDËRGJEGJËSIMIT DHE INFORMIMIT TË KOMUNITETIT

Për të siguruar mirëfunksionimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve, rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve si dhe sigurimin e pastërtisë në territorin e bashkisë, është shumë i domosdoshëm përfshirja dhe ndërgjegjësimi i komunitetit. Komuniteti jo vetëm duhet të kuptojë funksionimin e sistemit, por duhet ta mbështesë atë. **Suksesi i çdo skeme bazohet plotësisht nga mbështetja e përdoruesve. Është me rëndësi që të sigurohet zbatueshmëria e planit në 5 vjeçarin e ardhshëm, bashkia duhet të sigurojë një marrëdhënie partneriteti me komunitetin, ku ai:**

- Të ketë aksesueshmëri në shprehjen e mendimit, ankesave, sugjerimeve në lidhje me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve (anketa të zhvilluar rregullisht nga bashkia, njoftime të rregullta në stendën e bashkisë dhe në faqet online të saja dhe rrjetet sociale)
- Të informohet rregullisht në lidhje me skemën e menaxhimit të mbetjeve që aplikohet në territorin e bashkisë
- Të mundësohet transparenca e nivelit të tarifave të pastrimit dhe sistemit të faturimit për grumbullimin e saj
- Të njihet me detyrimet fiskale për pagesën e tarifës, detyrime të tjera në lidhje me skemën e menaxhimit dhe detyrimin për mbajtjen pastër të territorit të bashkisë

Konsumatorët si familjet, bizneset apo institucionet, në sajë të një fushatë të fortë ndërgjegjësimi mund të ndikojnë në përmirësimin e sistemit të mbledhjes, duke zbatuar kërkesat të hedhjes së mbetjeve në vendet e caktuara. Ndërgjegjësimi publik ndaj çështjeve të mbetjeve, pastërtisë së territorit dhe plotësimin e detyrimeve fiskale, konsiderohet si një prioritet dhe objektiv primar krahas objektivave të tjerë që lidhen me infrastrukturën apo me depozitimin e sigurtë të mbetjeve. Ka disa mënyrë për të rritur ndërgjegjësimin publik për çështjet e mbetjeve dhe për të dhënë informacion se si mund të trajtohen ato, me një kosto relativisht të ulët, por mjaft efektiv për arrijtjen e objektivit. Kjo mund të arrihet duke hartuar një plan ndërgjegjësimi i cili do të mundësojë:

- Ofrimin e një informacioni të përgjithshëm dhe të veçantë për komunitetin në lidhje me nismat vendore të mbledhjes, riciklimit të mbetjeve, pastërtisë së bashkisë dhe kostos së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve;
- Transparenca me komunitetin në lidhje me sistemin e faturimit dhe nivelin e tarifave të pastrimit;
- Ndërgjegjësimin e komunitetit për detyrimet ligjore për pagesën e tarifës së pastrimit, rregullat dhe detyrimet vendore;
- Nxitjen e qëndrimit miqësor ndaj mjedisit.

12.1 Metoda për komunikim dhe informim

Metodat më të përdorura të komunikimit të informacionit janë broshurat, artikujt në gazeta, njoftimet, dhe reklammat në TV dhe radio lokale, dhe fletëpalosje që shpërndahen në shkollë. Një zhvillim të lartë sot në vend ka edhe teknologjia e informacionit si edhe aksesit në internet. Kjo teknologji si edhe tërheqja pas rrjeteve sociale të komunitetit (kryesisht atij në moshë të

12.3 Integrimi i Perspektivës Gjimore në Menaxhimin e Mbetjeve

Vitet e fundit, Shqipëria ka ndërmarrë hapa për të integruar perspektivat gjimore në politikat mjedisore. Veprime specifike që lidhen me sektorin e menaxhimit të mbetjeve përfshijnë:

- Mbështetjen e pjesëmarrjes dhe lidhshmërisë të grave në menaxhimin mjedisor dhe qeverisjen vendore të mbetjeve.
- Rritjen e ndërgjegjësimit mbi ekspozimin specifik gjimor ndaj rreziqeve mjedisore dhe shëndetësore të lidhura me menaxhimin e dobët të mbetjeve (p.sh. trajtimi i mbetjeve të rrezikshme).
- Nxitjen e arsimit dhe formimit profesional të grave dhe vajzave në fusha teknike që lidhen me grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve, riciklimin dhe shërbimet mjedisore.
- Përmirësimin e aksesit të grave në mjete të qëndrueshme jetese të lidhura me riciklimin, ripërdorimin dhe nismat e ekonomisë qarkulluese.
- Ruajtjen dhe promovimin e njohurive tradicionale të grave lidhur me përdorimin e qëndrueshëm të burimeve dhe menaxhimin e mbetjeve në komunitet.

Megjithatë këtë progres, integrimi i perspektivës gjimore mbetet ende i kufizuar brenda shërbimeve të mbetjeve të ngurta bashkiake. Mbledhja e të dhënave, hartimi i politikave dhe pjesëmarrja në forcën punëtore shpesh mungojnë në një dimension të qartë gjimor.

12.4 Situata aktuale gjimore në shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Pogradec

Në shumë bashki, përfshirë edhe bashkinë Pogradec, gratë janë të nënpërfaqësura në pozicionet teknike, operacionale dhe drejtuese në sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Zakonisht, gratë angazhohen më shumë në role administrative dhe të shërbimit ndaj qytetarëve, ndërsa rolet operacionale si grumbullimi i mbetjeve, transporti dhe funksionimi i impianteve të riciklimit dominohen nga burrat.

Aktualisht, nuk ekziston një politikë gjimore e formalizuar që të trajtojë rekrutimin, trajnimin, promovimin ose pjesëmarrjen në vendimmarrje në shërbimet vendore të menaxhimit të mbetjeve. Po ashtu, nuk ka objektiva të përcaktuara për rritjen e përfaqësimit të grave në nivelet teknike apo drejtuese në departamentet bashkiake të mbetjeve.

Tabela 25: Plan i Veprimit për Barazinë Gjimore për Menaxhimin e Mbetjeve (2026–2031)

OBJEKTIVAT	MASAT DHE VEPRIMET	TREGUESIT DHE SYNIMET	PERIUDHA E ZBATIMIT
Promovimi i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve me përgjegjshmëri gjimore	Zhvillimi i konsultimeve me grupet e grave, bizneset dhe përfaqësuesit e komunitetit gjatë planifikimit të projekteve të menaxhimit të mbetjeve dhe fushatave të ndërgjegjësimit.	Numri i grave dhe burrave të konsultuar. Evidencë e komenteve të ndjeshme ndaj gjinisë të integruara në	2026–2031

13 RISHIKIMI I PLANIT

Ndjekja e zbatimit të planit duhet të jetë një proces i vazhdueshëm me vlerësime periodike (çdo 5 vjet) ose më shpesh nëse është e nevojshme për vlerësimin dhe rishikimin e objektivave dhe masave. Një rishikim i mundshëm i planit lidhet me procesin e planifikimit në nivel të Zonës së Mbetjeve Korçë, përputhjen me investimet e planifikuara dhe sistemet e vendosura në zbatim. Gjithashtu, ky rishikim mund të ndodhë dhe me vendosjen në zbatim të skemës së PZP, ose si baskim i të dyja zhvillimeve. Monitorimi dhe vlerësimi mund të funksionojë si një bazë për rishikimin e planit.

Çështje të rëndësishme për t'u marrë në konsideratë kur të analizohet ky plan janë sigurisht vlerësimi nëse objektivat janë përmbushur, nëse masat e parashikuara kanë qenë efektive apo jo. Një plan duhet të rishikohet gjithashtu, kur politika kombëtare e mbetjeve rekomandon apo detyron ndryshime thelbësore në mënyrën e menaxhimit të mbetjeve apo vendos objektiva të ndryshëm në funksion të obligimeve ndërkombëtare. Në këto raste, plani duhet të përballet me ndryshime të thella ose mund të jetë i nevojshëm hartimi i një plani të ri.

Përgjatë zbatimit të planit, duhen analizuar në mënyrë të vazhdueshme faktorët kryesorë që impaktojnë në parashikimet dhe objektivat e vëna në plan, si zhvillimi i popullsisë, ndryshimet lidhur me konsumin dhe llojin e mbetjeve të gjeneruara nga industritë apo ekonomitë shtëpiake. Gjithashtu analizimi i këtyre faktorëve shërben për të vlerësuar programet dhe projektet në proces apo që priten të fillojnë.

13.1 Monitorimi i planit

Ky plan duhet të parashikojë hapat në vazhdim, indikatorët dhe mjetet për të vlerësuar punën e bërë, për të verifikuar nëse objektivat janë përmbushur dhe të raportojnë tek vendimmarrësit. Qëllimi është që të sigurojë që autoriteteve përgjegjëse u është dhënë mundësia për të ndjekur zhvillimin dhe zbatimin e planit dhe të vendosin mbi masat shtesë, nëse është e nevojshme. Studimi bazë, i kryer për qëllim të këtij plani, do të shërbejë si një status bazë mbi të cilën do të vlerësohen arritja e objektivave dhe targeteve dhe mbi të cilin do të maten ndryshimi i indikatorëve të performancës së planit.

Monitorimi i planit duhet të jetë një proces i vazhdueshëm me vlerësime periodike dhe, nëse është e nevojshme mund të kërkojë rishikimin e objektivave dhe masave të planit. Monitorimi i planit do të shërbejë për:

- Për të dhënë informacion të vazhdueshëm tek bashkëpunëtorët dhe grupet e interesit, mbi statusin e zbatimit të planit;
- Për të analizuar statusin dhe për të vlerësuar efektivitetin e skemave të zbatuara;
- Për të përshtatur, modifikuar ose forcuar skemat apo programet në proces, ose për të krijuar të reja më të përshtatshme apo të efektshme;
- Për të mësuar, përditësuar dhe shpërndarë informacion dhe njohuri.

13.2 Procesi i monitorimit dhe vlerësimit të shërbimit

Bashkia do të ndjekë këto hapa në kryerjen e procesit të monitorimit dhe të vlerësimit të planit, si më poshtë:

14 KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

14.1 Rregullorja vendore

Bashkia Pogradec do të hartojë dhe miratojë rregulloren vendore për administrimin e shërbimit të mbetjeve, ku do të përcaktohet më tej roli dhe përgjegjësia e gjeneruesve dhe operatorëve të mbetjeve, me qëllim administrimin e suksesshëm të tyre brenda territorit të saj administrativ. Kjo rregullore do të përcaktojë rregullat dhe procedurat për administrimin vendor të mbetjeve, procedurat për trajtimin e ankesave të qytetarëve si dhe gamën e sanksioneve për mosrespektim të rregullave.

Praktikat më të mira të bashkive të ngjashme do të konsiderohen në hartimin e rregullores. Puna për hartimin do të nisë në vitin 2026.

14.1.1 Zbatimi dhe sanksionet

Përveçse si përcaktohet në Ligjin kuadër dhe aktet e tjera nënligjore për sektorin e mjedisit dhe mbetjeve, rregullorja vendore e administrimit të mbetjeve mund të përcaktojë një sërë sanksionesh specifike. Niveli i gjobave dhe sanksioneve duhet të bazohen në shërbimin e ofruar dhe në parimin "ndotësi paguan", ku shkelësi duhet të ndëshkohet me qëllim që të merren parasysh kostot e pastrimit apo mbledhjes së mbetjeve, kostot mjedisore dhe për më tepër të krijohet një sistem i drejtë për shkurajimin dhe parandalimin e ndotësve.

14.1.2 Pjesëmarrja e sektorit privat

Ekzistojnë një sërë përfitimesh dhe avantazhesh lidhur me përfshirjen e sektorit privat në sektorin e menaxhimit të mbetjeve:

- Sektori privat zotëron një ekspertizë më të mirë teknike dhe akses më të madh ndaj kapitaleve financiare sesa sektori publik;
- Skemat e minimizimit të mbetjeve që kërkojnë financime në teknologji (makineri dhe kontenierë) mund të jenë shumë të përshatshme për një bashkupnimim PPP;
- Administrata e sektorit privat është më efektive se ajo e sektorit publik;
- Aty ku sektori privat mund të realizojë shërbimet me standarde të njëjta apo më të mira dhe me kosto më të ulët për njësi, dhënia me kontratë e shërbimeve është një mundësi mjaft e mirë për të përmirësuar performancën e përgjithshme të shërbimeve të bashkisë;
- Duke qënë që është i orientuar drejt fitimit, sektori privat ofron kontroll më të mirë të standardeve operative dhe teknike, etj.

Kontraktimi i shërbimeve të largimit të mbetjeve voluminoze, mbetjeve të riciklueshme apo dhënia me koncesion e impianteve apo aktiviteteve për trajtimin mbetjeve (përfshirë edhe Stacionin e Transferimit të Mbetjeve), duhet të shihet si një mundësi për të tërhequr investime nga sektori privat në infrastrukturën e mbetjeve. Përfshirja e sektorit privat me anë të koncesionit apo partneritetit publik-privat duhet të nxitet si një mekanizëm për të ofruar një zgjidhje më të mirë ekonomike dhe që mund të jetë e pranueshme nga pikëpamja mjedisore.

14.1.3 Mbështetja politike

Menaxhimi i mbetjeve dhe pastërtia e qytetit duhet të konsiderohen të një rëndësie të veçantë për qytetin dhe banorët e tij dhe do të kërkojë një mbështetje dhe inkurajim të fortë nga Këshilli Bashkiak për të arritur objektivat e tij. Në këtë kuadër, nga njëra anë Këshilli Bashkiak duhet